



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 25.11.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 17.11.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik N.T.G "Blendi" lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material të shtypur", me Nr. të Prok: 632-20-5688-1-1-1, nxjerr:

### V E N D I M

1. **Aprovohet si** pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik N.T.G. "Blendi", e dt. 17.11.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Furnizim me material të shtypur**, me Nr. të Prok: 632-20-5688-1-1-1, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 12.11.2020 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
2. **Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 12.11.2020;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik N.T.G "Blendi" ,me datë 17.11.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:" **Furnizim me material të shtypur**", me Nr. të Prok: 632-20-5688-1-1-1,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 25.11.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

- Pas rishikimit të dokumenteve, autoriteti Kontraktues, konstaton se Operatori Ekonomik NTG"Blendi" e ka Sigurimin e tenderit;
- Sa i përket specifikacionit teknik ju sqarojmë se kjo nuk ka qenë kërkesë në dosjen e tenderit- pra nuk ka qenë kërkesë e nenit 6.4; 7.1 & 7.2; 8.1 & 8.2; 9.1 & 9.2 të dosjes së tenderit.

Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Tenderi juaj është eliminuar për arsye se nuk plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Faton Gutaj  
Menaxher i Zyrës së Prokurimit



**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës